

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fillim Skoro, kryetar i kolegjit, Have Haliti dhe Tonka Berishaj, anëtare, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.G., për shkak të veprës penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par. 8 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës të akuzuarit N.G., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Gjakovë, PKR.nr.87/17, të datës 11.01.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konformë nenit 390 të KPRK-së, me datë 22.05.2018, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet, si e pa bazuar ankesa e të akuzuarit N.G., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Gjakovë, PKR.nr.87/17, i datës 11.01.2018, vërtetohet.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Gjakovë, PKR.nr.87/17, të datës 11.01.2018, i akuzuari N.G., është shpallur fajtor për veprën penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par. 8 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së. Për veprën penale nga neni 365 par. 1 të KPRK-së, është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1(një) viti, ndërsa për veprën penale nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, është gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 1500 (një mijë e pesëqind) €, nëse dënimi me gjobë nuk paguhet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, dënimi i njëjtë shndërrohet në dënim me burg në kohëzgjatje prej 75 (shtatëdhjetë e pesë) ditësh, duke i llogaritur 20.00 €, për një ditë burgimi.

Konformë nenit 374 par.3 lidhur me nenin 69 par.1 të KPRK-së, i është shqiptuar dënim plotësues, i është konfiskuar arma automatike e tipit ASH-78, tip-1, kalibër 7.62x39 mm, me nr. serik 024905-85, e cila ishte objekt i veprës penale.

I akuzuari është obliguar që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej 50 (pesëdhjetë) €, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 (pesëdhjetë) €, në afat prej 15 ditëve, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë paraqitur.

I akuzuari, N.G., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, i akuzuari të lirohet nga aktakuza ose aktgjykimi të prishet, lënda të kthehet në rivendosje sa i përket veprës penale nën pikën e parë të dispozitivit të aktgjykimit, kurse në seancë të kolegjit ka prezantuar av. Z.Gj. sipas autorizimi e cila e ka mbështetë ankesën e të akuzuarit në tërësi.

Prokuroria e Apelit me parashtresën PPA/I.nr.163/18, të datës 25.04.2018, ka propozuar që ankesa e të akuzuarit N.G. të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, konform nenit 390 par.1 dhe 4 të KPPK-së, ka mbajtur seancën e kolegjit, në të cilën prezantuan, Prokuroria e Apelit, Argita Bollatoviq, mbrojtësja e të akuzuarit me autorizim av. Z.Gj., i dëmtuar F.Ll., në seancë nuk prezantoi i akuzuari, N.G., edhe pse ka qenë i njoftuar në mënyrë të rregullt për kohën dhe mbajtjen e seancës, për arsye se gjendet jashtë shtetit.

Gjykata e Apelit, ka shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të akuzuarit, N.G., pas vlerësimit edhe të shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesa e të akuzuarit është e pa bazuar.

I akuzuari pretendon se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptueshëm, kundërthënës në brendinë, në kundërshtim me vetveten, se në arsyetim nuk janë të paraqitura fare faktet vendimtare, kurse ato që janë të paraqitura janë plotësisht të pa qarta dhe kundërthënëse. Se gjykata e shkallës se parë nuk ka arritur ti vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, të vërtetoj siguroj se si ka ndodhur rasti ditën kritike, si dhe nuk i kanë dëgjuar dëshmitarët e propozuar, aktgjykimi i ankimuar nuk është përpiluar konform nenit 370 par.7 të KPPK-së, se gjykata e shkallës se parë, në arsyetim të aktgjykimit nuk i ka sqaruar në mënyrë të plotë faktet që i konsideron të vërtetuara, dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin, sepse nuk i ka vlerësuar drejt se cilat prova kanë qenë vendimtare, por vetëm i ka përshkruar deklaratat e dëshmitarëve, pa i argumentuar me fakte konkrete.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit, pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit nuk qëndrojnë, se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kjo gjykatë i vëren edhe sipas detyrës zyrtare që kishin me ndikuar në anulimin e aktgjykimit, aktgjykimi i ankimuar është përpiluar në harmoni me dispozitat e nenit 370 par.7 dhe të KPPK-së. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur në mënyrë të plotë dhe të qartë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara. Aktgjykimi i ankimuar përmban arsyet e duhura faktike dhe juridike mbi të gjitha faktet relevante të kësaj çështje penale, të cilat arsye si të drejta dhe të ligjshme i pranon edhe kjo gjykatë, sepse kanë mbështetje në provat e administruara nga gjykata e shkallës se parë.

I akuzuari pretendon se me aktgjykimin e ankimuar gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, se prokuroria nuk ka arritur fare ta vërtetoj aktakuzën në asnjë fazë të procedurës, meqë gjykatës nuk i ka ofruar prova me të cilat do të vërtetohej se i dëmtuari është qëlluar me predhën të cilën ka shtënë ai, se me të njëjtën pushkë ka shtënë edhe dikush tjetër ngase në atë ditë 17.04.2018, ka pasur aheng në shtëpinë e tij, ka gjuajtur 3-4 herë dhe gjuajtjen e ka bërë diku rreth orës 12-13:30 min. dhe më pas armën e ka lënë në garazh, se ka pasur mundësi derisa ka qëndruar arma në garazh dikush

tjetër ta përdor armën, ka pasur mysafir dhe ka pasur të shtëna edhe jashtë oborrit të tij, po ai nuk e ka parë se kush ka gjuajtur me armë, ka qenë i angazhuar me mysafir dhe nën ndikim të alkoolit, nuk e ka ditur që arma ka qenë e mbushur, por këtë gjë e ka vërejtur pasi që ka ardhur policia dhe e ka parë që ka plumba, se është shkelur e drejta e mbrojtjes se tij se gjykata nuk i ka dëgjuar dëshmitarët e propozuar nga ana e mbrojtjes.

Gjykata e Apelit i ka analizuar pretendimet të akuzuarit në ankesë dhe të mbrojtëses së tij gjatë seancës se kolegjit, që sipas tyre gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga gjykata e shkallës se parë dhe konstaton se janë të pa pabazuara ato pretendime, se gjendja faktike është vërtetuar nga provat e administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, nga dëshmia e të dëmtuarit F.L., dëshmitarëve p, si dhe provave materiale, ekzaminimi i armës më të cilën është shtënë, predhës dhe gëzhgjës, raportit të këqyrjes së vendit të ngjarjes, mendimit të eksperteve mjeko- ligjor dr. F.D. dhe V.H. lidhur me lëndimet e cilat i kishte marrë i dëmtuari, dëgjimit të akuzuarit i cili nuk e ka mohuar se ditën kritike kishte shtënë me armë. Nga të gjitha këto prova është vërtetuar se i akuzuari N.G. me dt. 17.08.2014, rreth orës 15:30 min , në fsh. ... Komuna e Gjakovës, me rastin e një ahengu familjar në shtëpinë e tij nga arma e tipit ASH-78, të kalibrit 7.62x39mm, me nr. serik 024905-85, kishte 3-4 herë në ajër dhe një predhë e kishte goditur të dëmtuarin F.L.-n në kokë deri sa gjendej së bashku me familjen e tij në oborrin e shtëpisë se tij në fsh. ...r, duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore të rrezikshme për jetë, në momentin e shkaktimit dhe me pasoja të përhershme të konstatuara nga eksperti mjekoligjor dr. F.D..

Kjo gjendje faktike është vërtetuar nga dëshmia e të dëshmitarit F.L., i cili ditën kritike kishte qenë shtëpinë e tij duke punuar në oborrin e shtëpisë së tij një fsh. ...r, ku prezent kishin qenë bashkëshortja e tij D., djali M., vajzat M. dhe M. dhe nusja e djalit B., dhe rreth orës 15:30 min. kishte dëgjuar të shtëna të njëpasnjëshme dhe një plumb e kishte goditur në kokë, pastaj familjarët e kishin dërguar në spital, i ishte nënshtruar operacionit dhe kishte qëndruar për 40 ditë në QKUK në Prishtinë. Në fillim nuk kishte pasur njohuri se kush kishte shtënë, më vonë e kishte kuptuar se nga kush ka ardhur plumbi, mirëpo me familjen e të akuzuarit më parë nuk ka pasur asgjë të keqe, por pas rastit i akuzuari dhe familjarët e tij nuk janë interesuar fare për gjendjen e tij shëndetësore.

Dëshmitarët D.Ll. dhe M.Ll., të cilët ditën kritike ishin së bashku me të dëmtuarin në oborrin e shtëpisë së tyre, njëjtë e kanë përshkruar rastin se si i dëmtuari është goditur nga një predhë në momentin kur ka qenë duke punuar në oborrin e shtëpisë së tij, menjëherë e kanë dërguar në spital.

E kjo është vërtetuar edhe nga provat materiale ekspertiza e Agjencionit të Kosovës për Forenzikë, se predha me të cilën është goditur i dëmtuari F.Ll. dhe është nxjerr nga koka e tij është gjuajtur nga pushka automatike ASH-78, e cila është konfiskuar nga i akuzuari, kurse nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, në oborrin e shtëpisë të akuzuarit janë gjetur gëzhgjetat e pushkës automatike ASH-78, të kalibrit 7.62x39 mm, ku prezent ka qenë edhe pronari i shtëpisë dhe e ka dorëzuar armën me të cilën kishte shtënë të cilën armë e kishte gjuajtur 500 m. larg shtëpisë. Gjithashtu edhe nga raporti i eksperti mjekoligjor dr. F.D. është konstatuar se i dëmtuarit F.Ll., i është goditur nga arma e zjarrit në regjionin temthor të anës së djathtë të kokës, nën cipën e anës së djathtë të trurit, duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore të rrezikshme për jetë në momentin e shkaktimit dhe me pasoja të përhershme për jetë.

Gjykata e Apelit, vlerëson se mbrojtja e të akuzuarit N.G. , është në kundërshtim me dëshminë e të dëmtuarit dhe provave tjera materiale me qëllim të shmangies se përgjegjësisë penale, se nuk është kontestuese se i akuzuari N.G., ditën kritike me rastin e një ahengu familjar në shtëpinë e tij nga pushka automatike ASH-78, kishte shtënë 3-4 herë në ajër dhe një predhë e kishte goditur të dëmtuarin F.Ll. në kokë, sepse predha e cila është nxjerrë nga koka e të dëmtuarit F. sipas ekspertizës balistike i ka takuar armës të cilën e ka përdorur i akuzuari. Kurse nuk qëndron mbrojtja e të akuzuarit se armën fillimisht e kishte lënë në garazh, e që ka pasur mundësi që dikush tjetër nga mysafirët ta përdor, se i akuzuari armën pas rastit e kishte fshehur 500-600 m. larg shtëpisë së tij, të cilën e kishte dorëzuar në polici, por me këtë i

akuzuari është munduar të i ikë përgjegjësisë penale, gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të saktë i ka vërtetuar të gjitha faktet relevante, nuk ka lënë dilema, dhe arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë i aprovon edhe kjo gjykatë.

Nga të gjitha provat të cilat janë administruar, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vërtetuar, se i akuzuari N.G., ka vepruar nga pakujdesia e vetëdijshme, edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit të tij për shkak të gjuajtjes me armë në mënyrë të pa kontrolluar, por me mendjehetësi ka menduar se nuk do të ketë pasoja, ku në atë rast është goditur i dëmtuari F.LI. i cili në atë moment kishte qenë në oborrin e tij duke punuar, me ç'rast nga predha e cila e ka goditur në kokë i janë shkaktuar lëndime të rënda trupore me pasoja të përhershme të shëndetit, sepse tani nuk i funksionin dora dhe këmba e majtë, me çka i akuzuari ka kryer veprën penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm .

I akuzuari pretendon se vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike respektivisht vlerësimi i gabuar i fakteve dhe provave ka pasur për pasojë shkeljen e ligjit penal në dëm të tij, ngase nuk është provuar me asnjë provë materiale relevante e asnjë fakt qoftë i drejtpërdrejtë apo i tërthortë se e ka kryer veprën penale e cila pretendohet se i vihet në barrë, janë aplikuar gabimisht dispozita e Kodit Penal, bazuar në këtë nuk është dashur që të dënohet, por të lirohet nga aktakuza në mungesë të provave ngase nuk ka marrë asnjë veprim inkriminues lidhur me veprën penale që i vihet në barrë.

Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit, janë të pa bazuara. Se gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin penal, kur ka konstatuar se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par. 8 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtje në pronësi kontroll, posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, të, për të cilat vepra penale gjykata e shkallës së parë e ka shpallur fajtor, pasi që më parë ka gjetur se i akuzuari është penalisht përgjegjës.

Sa i për këtë vendimit mbi dënimin, i akuzuari pretendon se me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kanë ndikuar në marrjen e vendimi të kundërligjshëm mbi dënimin, ashtu që në mungesë të provave fajësuese, propozon të lirohet nga përgjegjësia penale.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të dënimit ka pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 73 të KPRK-së, të cilat kanë ndikuar në llojin dhe në lartësinë e dënimit, ku si rrethana lehtësuese për të akuzuarin ka marrë parasysh se, më parë nuk ka qenë i dënuar, është penduar thellë, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përseris vepra tjera penale, është i gjendjes se varfër ekonomike, i martuar dhe babë i tre fëmijëve, se veprën penale e ka kryer nga pakujdesia, kurse si rrethana rënduese nuk gjetur, i akuzuari në ankesë dhe as mbrojtësja e tij gjatë seancës se kolegjit nuk theksojnë rrethana konkrete lehtësuese të cilat kishin me ndikuar që të akuzuarit ti përcaktohet një dënim më i butë, nga ato rrethana që i ka pasur parasysh gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit. Nga këto arsye Gjukata e Apelit nuk e aprovoi ankesën e të akuzuarit dhe mbrojtëses tij për një dënim më të ulët. Sipas kësaj Gjykate dënimi që i është shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë, është në harmoni me intensitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryera penale, se ky dënim duhet të jetë në shërbim të preventivës së përgjithshme, forcimit të moralit të shoqërisë, përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se dënimi i shqiptuar është në funksion të parandalimit të kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëj rehabilitimin e tij dhe të ndikoj edhe në personat tjerë që mos të

kryejnë vepra penale, me të cilin dënimin ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPK-së.

Nga çka u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 401 të KPPK-së.

### **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

PAKR.nr.173/18, i datës 22.05.2018

Procesmbajtësja

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit,

Syzana Goxhuli

2. Have Haliti

1.Fillim Skoro

3. Tonka Berishaj